



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME QARKU SHKODËR SH.A

Shkoder, me 06.10.2023

### **PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Sherbime**

#### **PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

#### **OBJEKTI I PROCEDURËS:**

Upgrade i programit te faturimit, migrim i te dhenave, audit dhe web serviseve per pagesa

#### **KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

Programim te programeve kompjuterike dhe konsulence

#### **VLERA E FONDIT LIMIT:**

1.500.000 (Nje milion e peseqind mije) leke pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor SHRUKQSH ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Fondi limit eshte perlllogaritur nga Sektori I Planifikim -raportim bazuar ne urdherin nr. 134, date 03.10.2023 nga Sektori Planifikim/raportim.

Specifikimet teknike jane hartuar nga pergjegjesi i IT Arsen Tafilica si me poshte:

## **1. HYRJE**

## **1.1. Autoriteti Kontraktues**

Shoqëria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Qarku Shkoder sh.a

## **1.3. Situata Aktuale në UK**

Shoqëria Ujesjellës Kanalizime Rajoni Shkodër përdor Sistemin e Faturimit AL-BILLING për Administrimin e Abonentëve, Faturimin, Arkëtimin, Ankesë/Kërkesat si dhe Faturën Online dhe atë të Leximeve AL-BILLING AMS MOB 4.4.4 për realizimin e leximeve të matësave nga Lexuesit në terren dhe administrimin e tyre (marrjen online dhe kalimin e tyre për faturim).

# **2. OBJEKTIVAT, QËLLIMI DHE REZULTATET E PRITURA**

---

## **2.1. Objektivi i Përgjithshëm**

- ✓ Zhvillimi i Sistemit të Faturimit Al-Billing për shtimin e kapacitetit të përpunimit të të dhënave të abonentëve dhe administrimit të tyre
- ✓ Zhvillimi i Sistemit të Faturimit Al-Billing për administrimin e tarifave të faturimit dinamike me përqindje
- ✓ Implementimi i shërbimeve të pagesave nëpërmjet përdorimit të web service dhe ofrimit të tyre për të gjithë kanalet e pagesave
- ✓ Implementimi i Sistemit të Auditit Omega Core Audit me qëllim sigurimin e aksesit dhe veprimeve në bazen e të dhënave
- ✓ Shtimi i kapacitetit të Sistemit të Leximeve nëpërmjet pajisjeve mobile (PDA) nga lexuesit

## **2.2. Qëllimi**

Vijimësia e punës për administrimin e abonentëve, faturimit, pagesave dhe realizimin e leximeve nëpërmjet pajisjeve mobile (PDA) nga lexuesit, migrimi i të dhënave dhe përmirësimi i procesit të administrimit dhe kontrollit të të dhënave.

## **2.3. Rezultatet që duhet të arrihen nga Kontraktori**

- ✓ Përshtatja dhe migrimi i të dhënave të Ujesjellësit të Vau Dejes
- ✓ Përshtatja dhe migrimi i të dhënave të Ujesjellësit të Koplikut
- ✓ Përshtatja dhe migrimi i të dhënave të Ujesjellësit të Pukës
- ✓ Zhvillimi dhe përshtatja e formave të administrimit të abonentit dhe të dhënave të lidhura me të

- ✓ Zhvillimi dhe përshtatja e formës së konsultimit për shfaqjen e të gjithë të dhënave të mundshme (kontrollin e faturës së fiskalizuar, faturës së printuar me të gjithë elementët)
- ✓ Krijim dhe ndarje të raporteve për faturimin, arkëtimin dhe debinë sipas Bashkive dhe Njësive Administrative
- ✓ Shtimi i Sigurisë së aksesimit të sistemit nga lexuesit, mbrojtja e sistemit nga sulmet kibernetike
- ✓ Implementimi i saktë i licensave të Omega Core Audit, lidhja me DB në përdorim të AK
- ✓ Qendrueshmëria dhe Zgjerueshmëria e Sistemit
- ✓ Versionimi dhe aplikimi i modifikimeve të lidhura me zhvillimet
- ✓ Ruajtja e historikut të ndryshimeve të leximeve, faturimeve dhe arkëtimeve
- ✓ Trajnimin e IT për zhvillim dhe përshtatje të sistemit

---

## **3. SUPOZIMET DHE RISQET**

---

### **3.1. Supozimet e Projektit**

Realizimi i këtij projekti bëhet nën supozimin që do të ketë një përfshirje total të aktorëve kyç si në zhvillimin dhe implementimin e sistemit Al-Billing, azhurnimin dhe migrimin e të dhënave, apo implementimin e shërbimit të pagesave dhe trajnimit të përdoruesëve.

Përfshirja e plotë e aktorëve kyç është thelbësore për mbarëvajtjen me sukses të projektit.

### **3.2. Rrisqet**

Mos përfshirja e të gjithë aktorëve kyç do të sjellë mangësi në zhvillim, implementim dhe funksionalite të kërkuara si dhe në saktësinë e të dhënave.

---

## **4. QËLLIMI I PUNËS**

---

### **4.1. Të përgjithshme**

Institucioni administrues pranë të cilit do të realizohet implementimi lidhur me Sistemin AL-BILLING, Migrimet, Pagesat Online dhe Sistemin e Leximeve për Leximet me Mobile (PDA) dhe trajnimi i përdoruesëve do të jetë Shoqëria Ujësjiellës Kanalizime Rajoni Shkodër Sh.a.

#### 4.1.1. Përshkrimi i detyrës

Shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Rajoni Shkodër Sha kërkon që të:

- ✓ Përshtatja dhe migrimi i të dhënave të Abonentëve të Ujësjetllësit të Vau Dejes
- ✓ Përshtatja dhe migrimi i të dhënave të faturave dhe arkëttimeve të lidhura me faturat të Ujësjetllësit Vau Dejes
- ✓ Përshtatja dhe migrimi i të dhënave të Abonentëve të Ujësjetllësit të Koplik
- ✓ Përshtatja dhe migrimi i të dhënave të faturave dhe arkëttimeve të lidhura me faturat të Ujësjetllësit Koplik
- ✓ Përshtatja dhe migrimi i të dhënave të Abonentëve të Ujësjetllësit të Puke
- ✓ Përshtatja dhe migrimi i të dhënave të faturave dhe arkëttimeve të lidhura me faturat të Ujësjetllësit Puke
- ✓ Kontrolle shtesë për emrat e abonentëve, të dhënave ndihmëse si NID apo përdoruesin, faturimeve dhe pagesave.
- ✓ Zhvillimi dhe përshtatja e formave të administrimit të abonentit dhe të dhënave të lidhura me të dhe kufizimi për marrjen e të dhënave të detyrueshme si NID, NIPT, etj.
- ✓ Shtimi i kontrolleve dhe përshtatjeve për njohjen dhe kontrollin e NID si element të detyrueshëm
- ✓ Azhornimin dhe kontrollet e numrave të kontratave me fasha, sipas përcaktimit të ujesjetllësit
- ✓ Shtimi i opsionit të printimit të kontratës tip për të gjithë klientët
- ✓ Shtimi dhe saktësimi i statuseve të kontratave të abonentëve
- ✓ Shtimin e tarifave të faturimit duke mbartur përcaktimet sipas ujesjetllësave që do të importohen dhe azhurnohen në sistemin e AI-Billing
- ✓ Azhornimi dhe përcaktimi i të gjithë abonentëve sipas zonave dhe përcaktimeve të UKQSH
- ✓ Identifikimi dhe kontrolli i numrave serialë të matësave dhe njoftimi për dublikata dhe mos lejimi i tyre
- ✓ Shtimi i administrimit të listës së lexuesve dhe lidhja e tyre me UK Reader
- ✓ Indeksimi i abonentëve sipas vendndodhjes dhe rrugëve
- ✓ Shtimi në faturë i njoftimit të detyrimit si me vlerë ashtu edhe me numër faturash
- ✓ Shtim i formës së kontrollit për abonentë pasivë dhe rasteve me anomali me qëllim faturimin e saktë të taksave dhe tarifës së shërbimit
- ✓ Saktësimi i Zonave dhe nënzonave të faturimit dhe përshtatja e tyre me të dhënat e Bashkive dhe Njësive Administrative
- ✓ Zhvillimi dhe përshtatja e formës së konsultimit për shfaqjen e të gjithë të dhënave të mundshme referuar të dhënave të ujesjetllësave të tjerë (kontrollin e faturës së fiskalizuar, faturës së printuar me të gjithë elementët, fotot e matësave, etj.)
- ✓ Krijim dhe ndarje të raporteve për faturimin, arkëtimin dhe debinë sipas Bashkive dhe Njësive Administrative

- ✓ Shtimi i elementëve të detyrimit ligjor për fiskalizimin në faturë (NIVF, NSLF, Datë, etj.)
- ✓ Shtimin e kapacitetit të pagesave online si dhe lidhjeve të bankave tregtare
  - konsiston në zhvillimin e modulit të pagesave dhe ofrimin e këtij shërbimi online për të gjithë subjektet e interesuara në formën e shkëmbimit të të dhënave me web service
  - ky shërbim do të përfshijë metodat: kryej pagesë, konsulto faturën korente, konsulto faturat e pa paguara të abonentit, etj sipas përcaktimeve të ujësjellësit
- ✓ Rishikimi dhe përshtatja e modulit të konsultimit të faturës Online me ndryshimet e shtuara në sistemin Al-Billing dhe reflektimin e saktë të të dhënave
- ✓ Shtimi i opsionit të identifikimit nëpërmjet email dhe lehtësimi i konsultimit online
- ✓ Shtimi i ankesë / kërkesave online për abonentët dhe lidhjen e saj me përgjigjet nga ana e UKQSH
- ✓ Shtimi i një moduli për administrimin dhe ndjekjen e ankesë/kërkesave në Al-Billing referuar të drejtave dhe përcaktimeve nga UKQSH
- ✓ Shtimi në sistemin e faturimit i opsioneve për kthimin e përgjigjeve të ankesë / kërkesave
- ✓ Rishikimin e raporteve dhe azhurnimin e tyre për të reflektuar shtimin e të dhënave dhe përmirësimin e tyre
  - **Abonenti**
    - Raport auditi për ndryshimet në të dhënat e abonentit me të gjithë elementët si ishin dhe si janë bërë
  - **Faturimi**
    - Faturim total mujor - Kategori zonë presioni
    - Faturim total mujor - Kategori klienti
    - Faturim analitik mujor
    - Detajim faturimi për kategori
    - Shtimi i parametrave për faturim me periudha me të gjata se një muaj
  - **Arkëtimin**
    - Liste arketimi për periudhe
    - Detajim arketimi për grupim
    - Listë pagesash
  - **Tek raporte mbi debine**
    - Debia në datë të caktuar
    - Debia e përmbledhur sipas viteve
    - Debia për vite për datë të caktuar
    - Raport për numrin e debitorëve, listave dhe elementë të tjerë
    - Shtimi i parametrave për kërkimet e debitorëve me adresa, muaj, vlera, kategori, zona, etj.
- ✓ Rishikimin i indekseve dhe të gjithë SQL-ve që vonojnë dhe kanë nevojë për normalizim
- ✓ Implementim i sistemit të auditimit të bazave të të dhënave Oracle si core audit application

- Konsiston në mbrojtjen kundër kërcënimeve të huaja dhe/ose të brendshme, akseset e paautorizuar dhe zbatim të ndarjes së detyrave në përmbushjen e kërkesave të pajtueshmërisë rregullatore, ato të jashtme ose të brendshme.
- Auditimit të vazhdueshëm dhe mbrojtjes në kohë reale, duke ofruar shikueshmëri dhe kontroll të qartë në aktivitetin e bazës së të dhënave, madje edhe për përdoruesit e privilegjuar dhe më shumë, DBA-të
- Verifikim i plotë për objektet kryesore të DB në UKQSH dhe kontrollit të ndryshimeve
- ✓ Saktësimi dhe draftimi i procedurës së backup dhe përfshirja e të gjithë skemave në këtë procedurë
- ✓ Shtimi i Sigurisë së aksesimit të sistemit nga lexuesit, mbrojta e sistemit nga sulmet kibernetike
- ✓ Implementimi i sistemit të auditit Omega Core Audit së bashku me konfigurimet e nevojshme dhe raportet bazë
- ✓ Qendrueshmëria dhe Zgjerueshmëria e Sistemit
- ✓ Ruajtja e historikut të ndryshimeve të leximeve, faturimeve dhe arkëtimeve

#### **4.1.2. Hapësira gjeografike**

Sistemi i Faturimit AL-BILLING, përshtatja dhe migrimi i të dhënave, si dhe shërbimet e pagesave nvpvrmjet web service do të kryhen dhe implementohet në zyrat kryesore të Ujësjiellës Kanalizime Rajoni Shkodër Sha.

#### **4.1.3. Siguria e Sistemit**

Kërkesat për sigurinë e sistemit janë të përcaktuara qartësisht në seksionet e kërkesave funksionale dhe atyre teknike, si përsa i përket sigurisë dhe roleve të përdoruesëve (moduli i hyrjes në system dhe moduli i roleve dhe përdoruesëve) ashtu edhe sigurinë e infrastrukturës, backup, etj.

Çdo përdorues do të njihet nga sistemi në mënyrë që ai të ketë të drejtë të hyjë në të me anë të identifikimit me përdorues unik dhe fjalëkalimin e tij personal. Vetëm pas identifikimit të tij me të drejta plotësisht të përcaktuar, ai mund të vijojë me punën.

Të gjithë të dhënat e ruajtura në aplikacion, përfshirë edhe ato të konfigurimeve si dhe të përdoruesëve të sistemit duhet të ruhen në një bazë të dhënash RDBMS e cila plotëson kërkesat në lidhje me integritetin e të dhënave dhe sigurisë.

Sistemi duhet të suportojë mjete efçente auditimi, aktivizimin e ruajtjes së historikut dhe të ndryshimeve, përcaktimin e historikut të të gjithë veprimeve të të shkuarës dhe të ardhmes (modifikim, shtim, fshirje). Ruajtja të realizohet për të dhëna specifike në tabela dhe forma të cilat mund të zgjidhen nga administratorët e sistemit.

## KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës ...;
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimi

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

**2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

**2.1 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.1.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet 2021,2022, me nje vlere jo me te ulet se 40% e fondit limit te ketij prokurimi. **Kjo Kërkese konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e kerkuara jane ne perputhje me percaketimin e nenin 43/2 te VKM nr. 285 dhe tregon kapacitetin financiar te opratoreve ekonomik ofertues, duke vertetuar qendrushmerine dhe ekspriencen e operatoreve.

---

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43/1 të VKM 285, ku është lene mundesi entit prokurues qe te kerkoj vertetim mbi xhiron deri ne tre vitet e fundit te operatoreve ekonomik

**2.2 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

2.2.1 Furnizime te meparshme te ngjashme me nje vlere prej 20% te fondit limit te objektit te prokurimit, te realizuar gjate tre viteve te fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates, vertetuar me dokumentacionin vertetues si me poshte:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,

- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Kontrata e ngjashme është e domosdoshme për të vërtetuar eksperiencën e operatoreve ekonomik ofertues, me qëllim që të garantohet zbatimi i kontratës me sukses

---

**2.2.2** Operatori ekonomik duhet të dëshmojë që ka stafin e nevojshëm teknik të kualifikuar. Pjesë e stafit të Operatorit Ekonomik duhet të jenë të paktën:

- 1 (një) punonjës të certifikuar për zhvillim dhe mirëmbajtje infrastrukture;
- 1 (një) punonjës të certifikuar për zhvillim dhe mirëmbajtje network-u;
- 1 (një) punonjës të certifikuar për zhvillim dhe mirëmbajtje aplikacioni web/mobile.

Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri Operatorët Ekonomikë duhet të paraqesin kontratat e punës, certifikatat përkatëse si dhe listëpagesat e muajit **Shtator 2023**

### **Argumentimi**

Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale të shoqërisë është kërkuar personel i nevojshëm referuar zërave të preventivit të objektit për realizimin e kontratës në mbështetje të pikës 4 të Nenit 77 të Ligjit 162, datë 23.12.2020, për “Prokurimin publik”, ku përcaktohet se “në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie” si dhe në mbështetje të Nenit 39 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, pika 6, germa (c) ku specifikisht përcaktohet: Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: :..... një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose...” Gjithashtu, bazuar në ligjin nr. Nr.9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë” ku parashikohet se pagesat e kontributeve bëhen: “Nga personat juridikë, përjashtuar personat juridikë të regjistruar si



*tatimpagues të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, brenda datës 20 të muajit pasardhës. , kemi percakëtuat listepagesat e mujit Shtator 2023.*

**2.3.3** Operatori ekonomik duhet të jetë i autorizuar nga autorët e programit kompjuterik "Al-Billing", sistemi i faturimit në përdorim dhe rregjistruar pranë ZSHDA me Nr. 57 RDA per kategorinë e veprës "Programe Kompjuterike", Neni 7/A, ose ekuivalente. **Gjithashtu mund** të paraqesin Autorizim të lëshuar nga autorët e programit kompjuterik, që kanë të drejtën të ofrojnë shërbimin për "Programin kompjuterik AL Billing".

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është në përputhje me nenin 77 e LPP, si dhe nenit 40, pika 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Aktualisht Shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Shkodër Sh.a. përdor sistemin e faturimit "Al-Billing" me të drejtë autori dhe bazuar në Ligjin Nr. 35/2016 "Për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e tjera të Lidhura me to". Për të garantuar kalimin me sukses të të dhënave dhe punës me sistemin e Faturimit Al-Billing sipas kërkesave të AK, duhet që operatori ekonomik të paraqesë dokumenta që bindin se ka të drejtë të punojë me sistemin aktuale dhe mund ta zbatojë këtë kontratë sipas pritshmërive të AK ndaj kërkohet e drejta e autorit.

Njesia e Prokurimit